



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilazina Mëdona 13-12-2022			
Nr. i organit Org. brej	Numri i broj	Shkronja Prilaz	Vlera Mëdona
01-060 / 01-1470			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -X- të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **19.12.2022 (e Hënë) në ora 13:00.**

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjate vitit 2023.
3. Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022.
4. Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë.
5. Informatë për zbatimin e planit të KKSB-së për vitin 2022.

Viti, më 13.12.2022





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E NËNTË E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.11.2022 (e Premte)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 13:00. Në mbledhje morën pjesë: z. Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z. Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ramadan Deliu, znj. Zejnepe Osmani, znj. Liridona Bislimi, z. Jakup Demiri, znj. Zyrafete Rama, ndërsa mungoj z. Ilir Zuka. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkryetar, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e nëntë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Para se të hy në rend të ditës, kisha hap diskutim.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam një kërkesë, që për mbledhje të kuvendit me na ardhë një raport në kuadër të 16 ditëshit të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore për aq sa lejohet me ditë, se sa ka bë komuna, kush është kanë i kyqur që me pasë nje raport. Është mbajtur një aktivitet 16 ditë, pak a shumë me pasë mundësi me sjellë një raportë si një informatë.

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kisha kërku me pasë si lloj informate në seancën e ardhëshme. Kisha fillu me të parën, atëher e dimë që muaji tetor është muaji roz nëpër të gjitha komunat, njëashtu edhe në komunën tonë janë bërë disa kontrolla në institutin QKMF. Mendoj që është mirë me pas një informatë, se sa kontrolla janë bërë në komunën tonë, edhe në të njëjtën kohë, sa ka pas kërkesa që nuk kanë mundur të arrijnë t'i bëjnë kontrollat, edhe me u bë një statistikë me vitet paraprake, me pa nëse kemi ndonjë përmirësim ose ndonjë interesim jashtë mase, për shkak se mendoj që kemi komuna tjera fqinje që kanë më numër të banorëve sa të Komunës së Vitisë dhe kanë memografinë për tërë vitin, ndërsa ne kemi vetëm një herë brenda vitit ....., për shkak të numrit të banorëve, por nese kemi kërkesa të shtuara të banoreve të Komunës së Vitisë, që janë të interesum dhe kanë sheja për kontroll të mamografisë, besojë që ndoshta është në interes me pasë 2-3 herë të paktën brenda vitit. E kisha kërku këtë informatë me pasë për seancën e kuvendit. Një ashtu këtë vit shkollor ne si komunë kemi pasë të angazhuar 15 psikolog nëpër shkolla, 6 asistente për fëmijë, 4 msuese mbështetëse, 2 logopede dhe 1 pedagog special. Mendoj që DKA do të duhet me ofru një raport të detajizum rreth angazhimit se si është situata nëpër shkolla, deri aty ku është e nevojshme dhe ku ka hapsirë që, ne si institucion me kuptu se si qëndron gjendja psikologjike e fëmijëve tonë nëpër shkolla, pasi që po e dimë që kohëve të fundit jemi duke pasur rast, nuk po them jashtëzakonisht të mëdha, se shumicën e rasteve nuk është që jemi duke i kuptu ose po zbulohen me kohë, po është mirë me e ditë se si qëndorjmë si komunë në këtë raport me fëmijet tanë. E fundit, kjo nuk është si informatë për kuvend, po kisha dashtë me ditë tashti nga DKA, e kemi parë, se është hapë një konkursë për studentë për me apliku për bursa. Kjo është shumë mirë, përgëzime, po ajo çka është e paqartë për studentët që më kanë pyet jashtëzakonisht shumë, është te pjesa për kriteret për aplikim, mes tjerash ku thuhet të jenë studentë të fakulteteve drejtimeve deficiatare, si: Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane. Tashti studentët ta zëm që janë të fakultetit edukimit ose të universitetve tjera, më kanë pyet se, a

kanë të drejtë me apliku. A është kjo pjesë e specifikume vetëm për këta studentë apo kanë të drejtë edhe të tjerë. Nëse jo, kur do të kanë drejtë studentët e drejtimeve tjera për me fitu bursa, a do të hapni bursa prapë?

**z.Ramadan Deliu:** Liridona mirë e patë, se kur e keni shkru aty a kanë të drejtë fakultete private apo vetëm të shtetit.

**znj.Liridona Bislimi:** Për atë pjesë është në rregull, unë po flasë specifikisht për drejtimet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Do të bëjë përpjekje maksimale të siguroj informatën kundër dhunës në familje për këto 16 ditë i gjej ata të cilët mundën me na e dhanë saktë këtë informatë me Qendrën për Punë Sociale me sektorin përkatës, besoj që do t'i kemi. Çështje që e ngriti Liridona, besoj që do t'i kesh të dyat edhe në raportet e punës, por ju si antarë të KPF-së keni herë pas here me kërku informata lidhur me këto çështje, prandaj do t'i obligoj të dytë, edhe drejtoreshën e QKMF-së që është kanë në ballë të kësaj çështje së bashku me drejtoreshën e shendetsisë, që të na e sjellin statistikën që i kanë në detaje edhe për kërkesa. Me sa jamë në dijeni, edhe disa të tjera e kanë pasë një koordinim të plotë edhe me Gjilan e kanë pas mirëkuptimin, megjithatë do të bëjë përpjekje maksimale që ta marrësh një informacion të plotë. Çështjen e psikologeve. E di që është faza e parë apo viti i parë ta quaj që i kemi edhe psikologët edhe mësueset mbeshtetse, edhe asistentët. Unë besoj që një takim e kam pas me ta për shkak se kanë fillu me bë si lloj komiteti të cilët i kam përgëzuar për iniciativën të cilën kam kërku, që në atë komitet pas përfshirjes të jetë edhe faza e formimit të raportimeve individuale për secilin psikolog, për punën të cilën ka bërë dhe për gjendjen e nxënësve të cilët i ushtron nëpër shkolla dhe unë do ta kërkoj tashti, a do të mund të jetë në këtë seancë nuk e di. Te çështja e bursave, besoj që me prioritet do të jenë ato. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e rregulltë. Një keqpërdorim të cilët po na e bëjnë edhe zyrtarët në pranim të dokumenteve edhe komisionit që po paraqet gjithëherë problem është te studentët të cilët janë përsëritës të vitit, të cilët ata përjashtohen, por megjithatë gjithëherë i kemi problemet këtu, se studenti i cili e ka ndëgu vitin sivjet dhe në rast se nuk e ka mrrri kushtin, ai duhet të eliminohet nga kjo, se nuk konsiderohet se është në vit akademik të rregullt. Dhe e dyta, problemet që na e paraqesin vazhdimisht për shkak se edhe Fatlumi ka qenë kryetar i komisionit, është edhe te studentet të cilët i kanë përfunduar ligjëratat dhe në vitin e 5-të ai aplikon dhe nuk e ka të kurtë se ti je student, por ti e hup të drejtën, ke përfunduar ligjëratat dhe nuk është obligative me qëndru në Prishtinë apo Gjilan në konvikt, sepse nuk ke obligim të ligjëratave, por ke obligim vetëm mësmin, megjithatë po ju tregoj vetëm një të cilën ma ka dhënë një sygjerrim një punëtori i yni këtu të cilën do ta shqyrtoj brenda vitit, por këtë vit nuk do të vlenë, se e kemi rregulloren në fuqi pse nuk aplikojmë ne nuk e marrim një model të cilën na e kanë dhanë nga Shqipëria. Në Shqipëri nuk po e quajkan bursë, se gabim është bursë, se bursë është duhet të ju jepet studentave të dalluar dhe jep universiteti, komuna duhet diçka tjetër me dhanë. Përpara në ish komunizëm është quajtur kredi, dhe atje e kishin bërë një emërtim, janë para neve në këtë drejtim, mbështetje financiare, që konsideroj që është shumë e logjikshme si emërtim. Duhet ta diskutojmë për vitet në vijimë dhe në këtë i kanë përfshi edhe universitetet private të cilët janë të akredituara që e ka atë logjiken e vetë, por besoj që kemi me punu së bashku të gjithë edhe është fjala te rritja e fondit, se sivjet edhe me dashtë nuk mundemi më bë atë, do të tentojmë me fiksu numrin 150, por të them të drejtën është edhe mendim i kryetarit edhe i imi, që të gjithë ata të cilët aplikojnë dhe janë të rregulltë të japim të gjithëve tu i përjashtu ata të cilët janë 2 apo 3 prej familjeve e marrë vetëm 1, se kështu janë mundësitë financiare. Do ta shqyrtojmë mundësinë, besoj që krejt në atë drejtim pajtoheni pa dallim se bin aty edhe dallime partiake, se studenti nuk njef ngjyrim politik, por ai njef studimin dhe duhet me ja njoftë vetëm atë. Tashti sa do të na e mundësojnë mundësitë buxhetore do t'i shohim. Unë jam gjithëher idhtarë për krejt, sepse më dhimben ata të cilët janë nëpër studime, nëpër shkollë, nëse i ngjyrosim politikisht, është komuna e gjithëve, kanë të drejt konkurrimi.

**znj.Liridona Bislimi:** Sa është shuma që ka me perfitu një student?

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** 300 Euro, nuk po guxojmë me shku më shumë se, nëse shkojmë më shumë i eliminojmë, se komunat tjera e praktikojnë Liridonë, i japin ka 500, i di plotë komuna, por i japin vetëm 50-tve, 70-tve. Kur kemi fillu këtë, unë e kam marr këtë model tu besu në konviktin e Prishtinës në atë kohë, tashti ndoshta ka leviz, është kanë 30 menza edhe konvikti. Ata shumica banojnë në privat, por ti duhesh me pas

ni bazë ku të nisesh, ajo ka qenë 10 muaj, janë studime që konsiderohet vit akademik dhe kemi marrë shumën 300 euro.

**z.Ramadan Deliu:** Prej nga e keni marrë ju këtë numër 150 për 150 vetë. Shembull po e marrim dalin 180, nëse janë krejt të rregullt, cilin e anulon.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Besojë që kemi me gjetë modelin për me ju dhanë krejtve.

**z.Fatlum Demiri, sekretar i kuvendit komunal:** Është rregullorja për ndarjen e bursave në të cilën janë të cekura kriteret, nëse ka më shumë se 150 që i plotësojnë kriteret, në rregullore thotë se, kush ka përparësi kushtet e barabarta atëherë vinë fëmijët e dëshmorëve, vinë familjet me social. Sa i përket drejtimet që e ceku Liridona, është interesant Liridonë, se kur kam qenë në komision 2-3 vite, nëse nuk gabojë në rregullore thotë që, kanë përparsi drejtimet devicitare, por në rregullore nuk janë të cekura, e arsyet që nuk janë, sepse këtu çdo vjet ndryshohet. Këtë vit mundet me pasë gjermanishten, vitin tjetër mundet me pas mjeksi, stomatologji. Ne si komision, qysh para 2-3 viteve kemi pas dërgu shkresë DKA-së, kemi pas kërku që me na njoftu neve si komision, se cilat janë drejtimet devicitare, që me ditë ne si komision paraprakisht, e pikërisht për këtë arsye e kanë cek që me ditë komisioni se cilët drejtime kanë përparësi.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetari e ceku këtë formën e Shqipërisë, se unë e kam lexu mirë edhe aty janë disa forma specifike për drejtime specifike.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Ajo është çështje tjetër, unë u ndala te komuna, ne çka duhet të bëjmë. Në Kosovë duhet shumë çështje mu shtru, për mua pa dashtë me nënçmu, nuk mund me barazu fakultetin juridik të cilin e kam kryer, unë me atë që kryen fiziken dhe matematiken. Nuk mundet një profesor me Edukatë Fizike, pa dashtë me nënçmu, se edhe ai është kuadër lamisë vetë me profesorin e Matematikës, Fizikës e Kimisë, por tek ne në Kosovë ende nuk është bërë kjo, është rreziku Fizika, se nuk e kemi drejtu atë të cilën po e lyp ti edhe unë domethan kur të del shteti, përshembull mua vitin e kalum më ka pëlqy forma e kryeministrit tashëm, por ai e ka dallu gjininë femrore, gjinia femrore e cila studion shkenca natyrore i merr nga 1 mijë euro ashtu ekujtoj, edhe i kanë marrë, është një stilumim i madh. E dyta, tani duhet me i shiku se qëto mundet me i marr çdo ministri e arsimit edhe me lyp prej DKA-së në nivel të Kosovës edhe me dalë me një udhëzim administrativ, të cilën mundet me thanë që ata të cilët e studiojnë Fizikën, Matematikën, me shiku ku kemi mungesë do ta kemi konviktin edhe menzen pa pagesë edhe konviktin e sigurum, ne jemi hala larg kësaj, por megjithatë ishalla hecim ngadal, se unë jam i interesum individualisht, që këto duhet me u nda në rast se dojmë me pasë kuadër të mirfilltë, nuk mundë psikologe pa dashtë me nënçmu se, për me kry Fiziken dhe Matematikën është zheg i madh dhe prandaj shkon profesori atje gjithë ditën me shkumës as bukën nuk mundet me hanger si duhet, dhe ti e pagun sa atë të Edukatës Fizike, që vrapon mas topit. Unë jam marak lojë me kqyr, por nuk është në rregull djali i Besimit është i barabartë me 10 shkolla të mesme të Kosoves, ajo është kontratë individuale te sportisti, është se si e gjejnë profesori i Edukatës Fizike, i Psikologjisë apo e ki këtu kryesuesin inxhinier me Mirlinden, Edukatë fizike, më falni që po e marrë shembull.

**znj.Liridona Bislimi:** Pas sa kohëve bëhët bartja e mjeteve te studentët që fitojnë bursa në momentin që publikohet që jan përfitues.

**z.Hasan Aliu, nënkryetari i komunës:** Ka ankesa, shqyrtimi dhe ata të cilët e kan fitu meniher fillojnë me i dorëzu kopjen e letërnjoftimin dhe gjirrollogarisë.

**znj.Liridona Bislimi:** Perafersisht sa kohë merrë kjo përshkak se ka studentë të rinjë që ka shumë të interesumë.

**z.Besnik Imeri Drejtori:** Studentet të cilët kan marrë viteve të kalume ku janë të regjistruemë në sistemin e thasrit, ndërsa këta të rinjë mundet deri 1 muaj të vonohet deri sa ti regjistron sistemi.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Drejtorja e arsimit ka pasë me sjell informatën e ka sjellë dhe i kemi dergu e-mail ka pas në seancën e kaluar, nuk e ka pru prap nuk e ka sjellë për fillim të vitit shkollor. Çështja e konkursit ka me na hap telashe, sepse është keq e pershkrume, e kam lexu sepse, rregullorja e përcakton mirë, kërkon që përzgjedhja bëhet përmes rregullores, mirëpo aty shkrun, të drejtë aplikimi kanë drejtimet deficitare të cilët i ka permen ata kanë vetëm të drejtë përparësi.

**z.Fatlum Demiri, sekretari kuvendit komunal:** Të gjithë studentët që janë banorë të Komunës së Vitisë pa kurrnifarë dallime etnike gjinore, racore, fetare dhe politike që janë të regjistruara në fakultete të universiteteve publike të Republikës së Kosovës, duke përfshirë studentët në studime pasuniversitare dhe doktraturë kanë të drejtë të konkurojnë.

**znj.Liridona Bislimi:** Unë i kam mbi 20 biseda të studentëve që më kanë shkrujtë, a kemi të drejtë edhe ne apo vetëm këta me Gjuhë Gjermane, Fizikë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kriteret për aplikim të jenë studentë me adresë të banimit të Komunës së Vitisë të jenë studentë të rregullt në universitetet publike të Republikës së Kosovës, të jenë studentë të fakulteteve drejtimet defecitare si Matematikë, Fizikë, Gjuhë Gjermane.

**z.Fatlum Demiri, sekretari kuvendit komunal:** Gabim është kjo, duhet të përmisohet, kanë përparsi, unë i kisha propozu DKA-së dhe Zyrës së Informimit, kur të bëhet permisimi i kësaj shpallje me ja bashkangjitë në link edhe rregulloren për ndarjen e bursës.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Për këtë mbledhje kemi parapa këtë:

### **R e n d i t e**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullore me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022-2026.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me peticipim.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Nëse ka dikush diskutim për rendit e ditës, urdhëroni? Nëse nuk ka, atëherë kërkoj miratimin e rendit të ditës me ngritje të dorës. Me të gjitha votat miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Nëse nuk ka ndonjë vërejtje: kush është me ngritje të dorës për miratimin e procesverbalit? Nga të gjithë anëtarët miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullore me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba

**z.Besnik Imeri, drejtor:** Si e dini, ministria na e ka kthyer Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba me përmirësime. Tek rregullorja bazë, neni 11, pika 11.3, shërbimet publike, neni 12, paragrafi 12.1.7, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, neni 11, pika 11.3.

**znj.Liridona Bislimi:** Nëse ka mundësi disa pika të na e shpjegohet për çka bëhet fjalë, jo të gjitha, por në pika të shkurtura.

**z.Besnik Imeri, drejtor:** Çështja e furnizimit me ujë të pijshëm për rastet sociale, familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës, për persona me aftësi të kufizuara, veteranë të luftës, paragrafi 12, pika 1.7 dhe paragrafi 12 pika 1.8 e njëjtës rregullore, fushën e çiradhënies së banesave, por nuk specifikohet me ligjin, ndërsa në paragraf shtohet se, komuna mundet të vendosë që, rasteve sociale t'i jep me qera banesat me çmim të subvencionuar. Në këtë rast kritetret duhet të vendosin që t'i japin të drejtë njerëzve që kanë më shumë nevojë.

Konsiderojmë që kjo çështje duhet të plotësohet dhe të saktësohet sipas legjislacionit në fuqi. Ministria e Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, çmimi për dru, neni 11, pika 11,3 ndryshohet nga 2.5 në 3 euro për drunjë teknikë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, fusha e ndërtimit, neni 28, paragrafi 28.1 i Rregullores 01-110/051057 për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha, shprehimisht thuhet: tarifa e taksës administrative për leje ndërtimore në Komunën e Vitisë është 2 euro për metër katror. Në këtë rast nuk është e precizuar për cilën kategori. Fusha e Agjensionit Kadastral, Ministria e Mjedisit MMPH konstaton se, rregullorja në fjalë për taksa, ngarkesa dhe gjoha është në përputhje me Udhëzimin Administrativ me numër 09/2020 për tarifën e shërbimeve për regjistrimin dhe të drejtën e pronës së paluejtshme.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A i kan plotësu që me i kthy se si i kanë kërku. Edhe vitin e kaluar 2 here na është kthy, domethanë na e ka kthy edhe një, pasi që e kemi themelmu me i harmonizu këto, sepse këto që i kemi plotësu më vonë nuk i kanë shti në atë rregulloren më herët kur e kanë përgadit, tana na kanë ardhë prap gabimet e njëjta. Këtu me pas kujdes vetëm të plotësohen që mos të kthehen për së dyti. A jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend? Me ngritje të dorës nga të gjithë të pranishmit. Të gjithë janë pro, kundër nuk ka.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim vendimit për aprovimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022-2026**

**z.Nexhat Arapi, udhëheqës i Dapartamentit të Zhvillimit Ekonomik në Drejtorinë për Financa:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Në pika të shkurtura, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Lokal është në kuadër të planeve strategjike që ka nxjerrë komuna, që dalin si obligim për institucionet e Kosovës, në këtë rastë për komunën tonë kjo strategji është hartuar në kombinim të MAPL-së, në përputhje me udhëzuesin për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026. Procesi i hartimit të strategjisë lokale të zhvillimit ekonomik ka filluar me propozimin e kryetarit të komunës, i cili me vendimin e posaqem ka themeluar komisionin për hartimin, i cili komision koordinon procesin e hartimit të këtij dokumenti. Procesi i hartimit dhe implementimit të strategjisë është i bazuar në principin e qasjes participuese, që do të thotë përfshirjen e të gjitha sektorëve, mekanizmave dhe formave të interesit gjatë tërë procesit. Në këtë kontest grupi koordinues ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e drejtorive dhe sektorët e qeverisjes komunale, duke grumbulluar të dhëna dhe shënimet rreth gjendjes dhe rrjedhave të përgjithshme. Pas analizimit, klasifikimit dhe sistemitit të të dhënave është prezantuar gjendja aktuale që figuron në këtë pikën 1. Në kapitullin 2 janë pasqyruar sfidat e zhvillimit ekonomik lokal nëpër sektorët e përcaktuar si dhe janë paraqitur rezultatet e spot analizës, përparsitë dhe mundësitë si faktor bazik për planifikim të mirë të zhvillimit, janë lokalizuar dobësitë dhe rreziqet si element që duhet të eliminohen ose duhet të minimizohet, efekti negativ i saj, kurse në kapitullin 3 janë të prezantuara objektivat ku janë potencuar 3 objektiva: zhvillimi i qendrueshëm ekonomik, zhvillimi i qendrueshëm social dhe menaxhimi i qendrueshëm. Te përcaktimi i objektivave për zhvillim ekonomik të komunës, është që të mundesojë komitetet të artikulojë se, ku dëshiron ai të jetë në të ardhme dhe çfarë rrugësh mund të ndiqen që të shkohet te ai zhvillim, ndërsa objektivat specifike janë të përcaktuara në drejtime të sakta për veprime dhe secila duhet të arrihet përmes zbatimit. Nuk po vazhdoj më shumë, sepse materialin do ta keni edhe të publikuar në web faqe dhe delegatëve do të ju dërgohet. Për ndonjë pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Nexhati ka qenë shumë i angazhuar në këtë strategji. Unë tani hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj.Liridona Bislimi:** Kam diskutu edhe në debatin publik, po e kam pas një pyetje atje në debat publik. Kam dashtë me e ditë se, keni mbajt shumë diskutime me qytetar, sa kanë qenë frytëdhënëse këto diskutime. A s'keni diçka me konkretish prej këtyre diskutimeve që janë propozu në debate e qe ju e keni marr e keni vendos në këtë analizë, tu e ditë që më keni thanë që jeni ende në përpunim të matrialit, e tash e bëjë këtë pyetje se: a janë perfundu këto? Dhe e kam dhanë një vërejtje për gabimet gramatikore. Deshta me ju thanë se janë përmirësu jashtëzakonisht shumë mirë. Tek pjesa e spot analizës, po më intereson me ditë: çka keni pas mangësi me të madhe edhe a ka pas diçka që keni mëndu që nuk mundeni me e realizu, qoftë si përparësi, si dobsi për shkak të koston apo hapësirës.

**z.Nexhat Arapi:** Te sftot analiza, e kemi pas ekipin dikune afër 30 të angazhuar, ekspert të komunës dhe kemi ardh në përfundim që, është në rregull, jemi mundu me e minimizu, se gjithmonë ka mundësi me punë, rreziqet i kemi eleminu maksimalisht dhe besoj që sipas neve ka dal mirë. Besoni që jemi mundu maksimalisht, nuk ka njeri në komunë që nuk e kam konsultu për sftot analizë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Sfidë ka me qenë zbatim i saj te pronat.

**z.Jakup Demiri:** Te spot analiza efektet do t'i jep gjatë implementimit të saj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, a jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon për kuvend me ngritje dore? Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të rinj për projektet me perticipim**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Drejtori me ka obligu sot me bë prezantimin e kësaj pike, sepse kish pas një takim sot ai. Propozimin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pestë të rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës më pak se një vit**

**z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës:** Kjo rregullore ka ardh nga niveli qendor. Ata e kanë punuar këtë rregullore, ju ka shku të gjith komunave, me siguri e ka pergatit kolegji i zyrtarve ligjorë. Para juve kemi sjellë rregulloren që të del në konsultim publik.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

**Procesmbajtësi:**  
**Fatlum Demiri**

---

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**  
**Bekim Azizi**

---

07-12-2022

Numri i Protokollit	Numri i Dregës	Shtatë Prillog	Vlera Vredësohet
02-035/02-1381			



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 11, 14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 13 dhe 8 paragrafi 3, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 07.12.2022, bën këtë :

**PROPOZIM VENDIM  
PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEQANT TË PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË  
PLANIFIKOHEN PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJATË VITIT 2023**

**Neni 1**

Me këtë propozim – vendim , propozohet të miratohet Lista e veqant e pronave të palujtshme të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023.

**Neni 2.**

Lista sipas nenit 1 të këtij propozim-vendimi për secilen pronë arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës , të dhënat kadastrale , qellimin e dhënjes në shfrytëzim , destinimi i pronës parashikimi.

**Neni 3**

Pjesë përberse e këtij propozim vendimi është Lista e veqant e pronave të Komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023 përfshirë kartifikaten e pronës dhe kopjen e planit.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi dhe procedurat tjera të parapara ,me të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë ne bashkpunim dhe kordinim me Drejtorit tjera të Komunës varsisht fushveprimtarisë përkatëse. Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

**Neni 5.**

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.







2

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



LISTA E VEQANT E PRONAVE TË PALUJTSHME TË KOMUNËS QË PLANIFIKOHET PËR  
DHËNJEN NË SHFRYTËZIM GJAT VITIT 2023.

Nr	Të dhënat kadastrale të pronës	Arsyetimi i interes publik dhe zhvillimi ekonomik	Destinimi	Periodha kohore për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme
1.	Njesisë kadastrale P-70101023-00991-0 në sipërfaqe prej 33358 m <sup>2</sup> , Njesisë kadastrale P-70101023-01576-0 në sipërfaqe prej 10553 m <sup>2</sup> , Njesisë kadastrale P-70101023-01577-0 në sipërfaqe prej 142999 m <sup>2</sup> në zonën kadastrale në Zhiti	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
2.	Njesisë kadastrale P-70101012-00641-7 në sipërfaqe prej 110044 m <sup>2</sup> , në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.
3.	Palujtshmeria e evidentuar në, numri i njësisë kadastrale: P-70101012-00641-1 në sipërfaqe prej 155000 m <sup>2</sup> , Bujqësore, në vendin e quajtur "Batanica" në zonën kadastrale në Budrikë e Epërme.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për Zonë industriale – ekonomike.	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatgjat.
4.	Njësit kadastrale me numër : P-70101007-02592-3, në sip. prej 102m <sup>2</sup> P-70101007-02592-4, në sip. prej 53m <sup>2</sup> P-70101007-02592-5, në sip. prej 96m <sup>2</sup> P-70101007-02592-6, në sip. prej 104m <sup>2</sup> P-70101007-02592-7, në sip. prej 156m <sup>2</sup> P-70101007-02592-8, në sip. prej 118m <sup>2</sup> Në zonën kadastrale në Viti.	Pronat e cekura planifikohen të jepen në shfrytëzim për parkingje publike, krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për parkingjet publike	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter
5.	Njesisë kadastrale me numër: P-70101018-00175-0, në sip. 211198 m <sup>2</sup> , P-70101018-00197-0, në sip. 96342 m <sup>2</sup> , P-70101018-00200-0, në sip. 130577 m <sup>2</sup> , P-70101018-00211-2, në sip. 8142 m <sup>2</sup> , P-70101018-00211-4, në sip. 206276 m <sup>2</sup> , Në zonën kadastrale në Devajë.	Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në fjalë dhe të hyrat vetanake për Komunë.	Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor	Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.

<p>6. Njësisë kadastrale me numër:  P-70101016-00528-0, në sip. 2804 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00527-0, në sip. 6416 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00498-0, në sip. 10392 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00499-0, në sip. 4785 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00500-0, në sip. 13896 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00529-0, në sip. 27085 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00503-0, në sip. 16364 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00502-0, në sip. 11070 m<sup>2</sup>,  P-70101016-00501-0, në sip. 8205 m<sup>2</sup>,  Në zonën kadastrale në Gushicë.</p>	<p>Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në sjahtë dhe të hyrat vetanake për Komunë.</p>	<p>Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor</p>	<p>Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter</p>
<p>7. Njësisë kadastrale P-70101040-01784-1 në sipërfaqe prej 37151 m<sup>2</sup>, Toka pyjore në vendin e quajtur "Zhar zhar" P-70101040-01785-0 në sipërfaqe prej 3968 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale në Sadovinë e Çerkezëve</p>	<p>Pronat e cekura planifikohet të jepen në shfrytëzim për krijimin e vendeve të lira të punës dhe rritjen e vlerës së parcelës në sjahtë dhe të hyrat vetanake për Komunë.</p>	<p>Prona e cekur jepen në shfrytëzim me destinim për shfrytëzimin bujqësor</p>	<p>Prona e cekur parashihet të jepet në shfrytëzim afatshkurter.</p>

Me datën 07.12.2022, Viti.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

13-12-2022

Nr. i organit Org. brejt		Komuna/Droj	Sh. Q. Cee Prillog	Vlera Vredësohet
01-016/01-1472				



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për  
periudhën Janar - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Tema: Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Kuvendit Komunal të Vitisë dhe komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, për periudhën Janar- Dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar edhe komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka realizuar po thuaja që 100% realizimin e planit të punës së kuvendit për vitin 2022. Kuvendi Komunal i Vitisë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, ka mbajtur gjithsej -XI- mbledhje të rregullta, -V- mbledhje solemne, dhe -I- mbledhje të jashtëzakonshme. Kuvendi ka miratuar gjithsej 81 vendime, 1 rregullore dhe 2 ndryshim plotësime të rregulloreve, 1 deklaratë, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat nga MAPL-ja.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili deri me sot ka mbajtur -X- mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithashtu është komitet obligativ, i cili këtë vit ka mbajtur -X- mbledhje.

Përveç këtyre komiteteve, kemi të themeluar edhe komitete të tjera, si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale;
2. Komiteti për Shërbime Publike;
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
4. Komiteti për Liritë të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore;
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit.

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë joobligative, kanë qen aktiv, dhe për secilin komitet e keni të bashkangjitur informatën e përgatitur nga kryesuesit e komiteteve.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

13-12-2022

Emri/Drej	Shtetësi	Vitet
01 - 016/01 -		1473



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të  
Komunës së Vitisë për vitin 2022**

**Dhjetor 2022**

Për :	<i>Kuvendin Komunal të Vitisë</i>
Nga :	<i>Valentina Mehmeti - Kryesuese e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Vitisë</i>
Lënda:	<i>Informatë mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë për vitin 2022</i>
Datë:	<i>13.12.2022</i>

## I N F O R M A T Ë

Të nderuar Këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë , i cili komitet është themeluar me datën 01.03.2022.

Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej VI mbledhje të rregullta.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar këto takime:

1. Zgjedhja e kryesise se KSHMS
2. Pergaditja e planit vjetor per KSHMS
3. a)Raport per realizimin e kontrollave sistematike te nxenesve te shkollave fillore te Komunes se Vitise per vitin 2022  
b)Raport per vaksinimin e femijeve, nxeensve dhe qytetareve te Komunes se Vitise, si dhe per vaksinimin kunder gripit sezonal dhe vaksinen AntiCovid
4. Raporti i programit per vizita shtepiace per nena dhe femije ne kuader te QKMF-se ne Viti
5. Vizite QKMF-se ne Viti
6. Prezantimi i informates rreth aktiviteteve te realizuara per vitin 2022, si dhe plani i punës për vitin 2023

Komitetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

**Kryesuese e Komitetit**  
**Valentina Mehmeti**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilafeno M/Dana 12-12-2022			
Nr. i organit Org broj	Numri/broj	Spajtimi Prilaf	Vlera Vrednesi
02-016/01-1422			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## **Informatë mbi punën e Komitetit për Shërbime Publike për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për Shërbime Publike**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Shërbime Publike**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë, i cili komitet eshte themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta, aq sa janë parapa në planin e punës së komitetit.

Komitetit për Komitetit për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

**Me datën: 12.12.2022**

**Kryesuesi i komitetit  
Basri Sylejmani**







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

13-12-2022

Prilidhja	Sh. D. 06	Vlera
Nr. i Urdhrit	Prilidhja	Vlerat
Org. t. r. e		

01-016/01-1471



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencave të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, i cili komitet është themeluar me datën 01.03.2022.

Që nga themelimi i Komitetit në muajin Mars 2022, ka filluar puna e këtij Komiteti fillimisht në përpilimin e planit të punës së këtij Komiteti duke i dorëzuar Kuvendit Komunal planin e punës për miratim nga anëtarët e Kuvendit Komunal në muajin Maj 2022.

Fillimisht duke ofruar një bashkëpunim të shkëlqyer me DKA-në dhe DKRS-në, për çka jemi edhe falënderues ndaj dy drejtorëve për gatishmërinë e treguar që të punojmë së bashku me Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Pastaj që nga muaji Maj është filluar me punën tonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë kësaj periudhe pasi kemi miratuar planin e punës, kemi filluar me vizitat nëpër shkollat fillore, për të parë më afër kushtet e punës dhe gjendjen e shkollave në komunën e Vitisë.

Shkollat të cilat i kemi vizituar në këtë fazë janë gjithsej 8 Shkolla fillore:

1. Shkolla Fillore "Bafti Haxhiu" Viti
2. Shkolla Fillore "Dëshmorët e Vitisë" Viti
3. Shkolla Fillore "Halil Alidema" Pozheran
4. Shkolla Fillore "Hysen Terpeza" Terpezë
5. Shkolla Fillore "Dëshmorët e Lubishtës" Lubishtë
6. Shkolla Fillore "Dom Mikel Tarabulluzi" Stubëll
7. Shkolla Fillore "Dëshmorët e 5 Prillit" Smirë
8. Shkolla Fillore "28 Nëntori" Vërban

Nga kjo vizitë na delë një e përbashkët:

- Të gjithë udhëheqësit e shkollave u pajtuan që duhet të rritet përgjegjësia, llogaridhënia, dhe respektimi i rregullave shkollore si nga ana e nxënësve, po ashtu edhe nga ana e mësimitdhënësve.

- Të gjithë u pajtuam se orientimi në karrierë duhet të filloj që nga klasa e 6 fillore që nxënësit të mund të zgjedhin talentin e tyre dhe përgatitjen profesionale.

- Te të gjitha shkollat problemi ishte i njëjtë për trajtimin e inventarit të vjetër.

Pastaj në muajt Korrik-Gusht, kemi përcjellur aktivitetet kulturore për ditët e diasporës të cilët aktivitete ishin nën organizimin e DKRS-së, ku kishim disa aktivitete kulturore, rinore, sportive etj.

Me fillim të vitit mësimorë, pasi ky vit shkollorë nuk filloj ashtu sikur ishte paraparë në kalendarin vjetorë mësimorë, kishim një zvarritje të procesit mësimorë për një muaj rresht, për shkak të grevës së përgjithshme në arsim. Kjo situatë u kalua dhe filloj procesi mësimorë në muajin Tetor 2022, ndërsa ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, filluam edhe vizitën e dytë nëpër disa shkolla të komunës së Vitisë.

Shkollat të cilat i kemi vizituar në këtë fazë janë:

1. Shkolla Fillore “Kenan Halimi” Skifteraj
2. Shkolla Fillore “Hasan Aliu” Remnik
3. Shkolla Fillore “Nazmi Pajaziti” Radivojcë
4. Shkolla Fillore “Skender Emerllahu” Ramjan
5. Shkolla Fillore “Nijazi Rexhepi” Sllatinë e Epërme
6. Çerdhja e Qytetit “Gëzimi Ynë” Viti
7. Shkolla Mesme Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës” Viti
8. Institucioni i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional – IAAP “Jonuz Zejnullahu” Viti

Nga kjo vizitë na delë një e përbashkët:

- Të gjitha shkollat janë furnizuar me lëndë djegëse (dru), për sezonën e dimrit.
- Të gjithë ishin për një bashkëpunim sa më të mirë me këshillat e prindërve që të mund të kontribuojmë të gjithë për një proces sa më të mirë edukativo-arsimor.
- Si sfidë e të gjitha shkollave ishin kabinetet e ndryshme që mësimi të jetë sa më inovativ, si dhe shpejtësia e rrjetit ishte një problem i theksuar nëpër shkolla.
- Gjithashtu edhe një sfidë te pastërtia, ku nga të gjithë menaxherët e shkollave u kërkua që pastërtia e shkollave të bartet te ndonjë kompani private me qëllim të përmirësimit nivelit të pastërtisë.

Nga puna jonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi vazhduar që të jemi në kontakt me organizatat e ndryshme jo qeveritare siç janë disa OJQ që veprojnë në komunën e Vitisë si dhe me disa shoqëri kulturore artistike që veprojnë në Viti si psh: AKV “Kemajl Azizi” në Viti.

Nga drejtori i AKV “Kemajl Azizi” z.Arsim Abazi u njoftuam për së afërmi me rezultatet, sukseset dhe angazhimet e shoqërisë që drejton të cilat rezultate ishin mbresëlënëse për të gjithë ne duke marrë edhe çmime në nivel shtetërorë, ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ju

ofruam bashkëpunim duke i inkurajuar që të vazhdohet me angazhim dhe punë në nxjerrjen e talenteve tanë, ku Vitia është një vatër e kahershme me talenta në fushën kulturore, artistike etj.

Në kuadër të punës si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport kemi pasur në takim në dy mbledhje drejtoreshën e DKA-së znj. Fatbardha Emini, për të diskutuar nga afër për sfidat në arsim dhe problemet që na rrethojnë në kuadër të fushës së arsimit, për çka edhe e falënderojmë drejtoreshën për një bashkëpunim të shkëlqyer me ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Gjithashtu në mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, prezent kishim edhe drejtorin e DKRS-së z. Valmir Sahiti, nga i cili u njoftuam për së afërmi me punën e DKRS-së, aktivitetet, angazhimet, puna etj. Nga drejtori z. Sahiti jemi njoftuar edhe për së afërmi edhe me mbështetjen financiare të OJQ-ve në komunën e Vitisë, për çka jemi falënderues për transparencën e treguar dhe gatishmërinë që në çdo kohë të mund të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve Vitias.

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, për periudhën mars-dhjetor 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta dhe 16 takime nëpër shkolla duke përfshirë: Shkollat e Mesme, Shkollat fillore dhe Qerdhën e Qytetit, si dhe në fushën e kulturës 4 takime, me përfaqësues të klubeve sportive etj.

Nga puna jonë si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport që nga marrja e detyrës jemi munduar që të jemi sa më bashkëpunues në mes veti pa dallim moshe, gjinie, e partie politike, duke i kaluar kështu edhe barrierat paragjyquese dhe duke u munduar të japim një mesazh se së bashku mund të ia dalim në arritjen e rezultateve për të adresuar problemet dhe sfidat e qytetarëve tanë, ku të ndërtohet një urë lidhëse në mes nesh si Komitet dhe ekzekutivit komunal.

Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij Komiteti për vitin 2023, të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

Me datën 13.12.2022

**Kryesuesi i komitetit**

**Musli Nezir**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPublika e KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranë: Prerjedës Mësona 13-12-2022

Nr i organit Orig. Nr.	Numri/Çroj	Shitjetë Prilog	Vlera Vendime
01	-016/	01	-1475



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi  
Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesja e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën Mars- Dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë, i cili komitet është themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë për periudhën mars-dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -VI- mbledhje të rregullta aq sa janë parapa me planin e punës se këtij komiteti për vitin 2022.

Komitetit për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

**Me datën: 12.12.2022**

**Kryesuesja e këtij komiteti  
Lindita Demelezi**





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

13-12-2022

Nr. i Organi Org. nr.	Adresa Adresa	Shërbimi Shërbimi	Vlera Vlera
01-016/01		1474	



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

**Informatë mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars - Dhjetor 2022**

**Dhjetor 2022**

**Nga: Kryesuesi i Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë**

**Për: Kuvendin Komunal të Vitisë**

**Informatë mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunal të Vitisë, më lejoni që para juve ta paraqes informatën mbi punën e Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë i cili është themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë, informata për periudhën mars- dhjetor 2022.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, Udhëzimin Administrativ MAPL, 05-2022 për procedurat e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përherëshme dhe komiteteve tjera në komuna ka të themeluar edhe Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë, i cili komitet eshte themelu me datën 01.03.2022.

Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë për periudhën Mars-Dhjetor 2022, ka miratuar planin e punës për vitin 2022, ka mbajtur gjithsej -IV- mbledhje të rregullta.

Komitetit për planifikim rregullim të hapësirave dhe mbrojtjen të mjedisit të Komunës së Vitisë, ka miratuar edhe planin e punës se këtij komiteti për vitin 2023 të cilin plan do ta dërgon në kuvend për miratim.

**Me datën: 13.12.2022**

**Kryesuesi i komitetit  
Remzi Salihu**







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilajena 12/12/2022

Nr./ organit Org broj	Numër/çroj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednues
02-016	01-1420		



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina

## Informatë për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë

Viti, Dhjetor 2022

**Bazuar në identifikimin rreziqeve në Planin e Integritetit për Komunën e Vitisë dhe propozim masat e marra për ruajtjen e integritetit të institucioneve komunale, ju informojmë për masat e ndërmarra nga organet e Administratës Komunale.**

**Plani për të cilin po ju informojmë, ka pasur të të identifikuar një sërë fusha të rrezikut, si: Sistemi i menaxhimit financiar, rexhistrimi dhe menaxhimi i aseteve, menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerzore, inspektimi, gjeodezia, prona dhe kadastra, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, bujqësia pylltaria dhe zhvillimii rural, shërbimet publike dhe gatishmëria emergjente si dhe komunikimi me akterët kryesorë të jashtëm**

**Për realizimin e këtij plani, Instirucionet e Komunës kanë ndërmarrë një sërë masash të përmirësimit për të gjitha grupet në rrezik.**

**Komuna e Vitisë, ka qenë e përkushtuar në menaxhimin e rrezikut të integritetit për tërë Organizatën, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë, në eliminimin e mundësive për korrupsion dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithëshme ndaj korrupsionit, ku për përkushtimin e Komunës për zbatimin e këtij Plani më së miri flet edhe Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, i cili raport nga ana e auditorëve cilësohet si raport i pakualifikuar.**

**Masat të cilat janë ndërmarrë nga Komuna për sistemin e menaxhimit financiar dhe rexhistrimin e menaxhimit të aseteve janë:**

- **Hartimi i buxhetit konform kufijve buxhetor nga Qarkoret Buxhetore nga Ministria e Financave**
- **Zbatimi i plotë i Rregullores për Tarifa, Taksa, Ngarkkesa dhe Gjoba**
- **Zhvillimi i procedurës gjithëpërfshirëse të brendshme për menaxhimin e buxhetit me përshkrim të qartë të aktiviteteve të ndërlidhura të raportimit dhe linjave llogaridhënëse**
- **Zbatimi i sanksioneve për mospërbushjen e obligimit për pagesën e taksave dhe tarifave**
- **Sigurimi i kapaciteteve të brendshme profesionale të stafit nëpërmjet trajnimit të specializuar**
- **Përmirësimi i menaxhimit të aseteve dhe cilësisë së kontroleve, ku për këtë është themeluar një komision i cili ka bërë vlerësimin dhe amortizimin e aseteve.**

**Masat të cilat janë ndërmarrë për menaxhimin e burimeve njerzore janë:**

- **Është menaxhuar me sukses procesi i rekrutimit të punëtorëve të rinjë**
- **Është zbatuar plotësisht Rregullorja për Procedurat e rekrutimit**
- **Është hapur një link i veçantë në Eeb faqen zyrtare të Komunës për ankesat që kanë të bëjnë me rekrutimin**

- Është menaxhuar me sukses si nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtoirve monitorimi i disiplinës në punë
- Është menaxhuar me sukses kontrolli i udhëtimeve zyrtare

#### **Masat të cilat janë ndërmarrë në Inspektim:**

- Përmirësimi i financimit të funksionit të inspektimit është menaxhuar me sukses
- Është bërë rritja e profesionalizmit të stafit sa i përket teknikave të veçanta
- Janë shtuar inspektimet Ad Hoc
- Është realizuar me sukses Plani i inspektimit

#### **Masat të cilat janë ndërmarrë në Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër:**

- Janë mbajtur trajnime adekuate profesionale për stafin e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për vlerësim të pasurive të patundshme, udhëzimeve ose kornizave për matjen e kadastrës
- Është siguruar transparencë e plotë në Drejtori duke krijuar hapësirë për punë
- Është rritur integriteti në rexhistrimin e pronës së paluajtshme si dhe është bërë futja dhe mbajtja e një sistemi funksional të skanimit dhe arkivimit profesional
- është menaxhuar me sukses rexhistrimi dhe çrexhistrimi i hipotekave në raport me bankat, noterin dhe organet tjera gjegjëse

#### **Masat të cilat janë ndërmarrë në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:**

- Është bërë koordinimi me Sektorin e Buxhetit sa i përket planifikimit të buxhetit për nevojat e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Janë rritur fondet për shëndetësi
- Është rritur stafi shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore
- Është përmirësuar infrastruktura në objektet shëndetësore
- Është zbatuar në përpikëri Rregullorja për ndarjen e subvensioneve

#### **Masat të cilat janë ndërmarrë në Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural:**

- Është bërë përcaktimi i sektorëve që duhet të jepen subvensione, ku subvensionet më të mëdha janë dhënë në sektorin e Bujqësisë
- Është menaxhuar me sukses transparenca, efektivitetit dhe efikasiteti në ndarjen e subvensioneve

- **Stafi i Drejtorisë është trajnuar në mënyrë adekuate**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Shërbime Publike dhe Gatishmëri Emergjente:**

- **Është menaxhuar me sukses procesi i menaxhimit të kontratave të shërbimit**
- **Janë ngritur kapacitetet e stafit të përfshirë në hartimin e projekteve, kjo përmes trajnimeve adekuate**
- **Drejtoria ka marrë pjesë aktive në procesin e planifikimit të buxhetit duke identifikuar nevojat për planifikim buxheti**

**Masat të cilat janë ndërmarrë në Komunikim me akterët e jashtëm:**

- **Zhvillimi i masave për të komunikuar me akterë të jashtëm është menaxhuar me sukses ku edhe janë mbajtur 14 dëgjime buxhetore**
- **Është bërë prezantimi i portalit të transparencës në Web Faqen zyrtare të komunës, ku edhe janë publikuar dokumenti buxhetor i Komunës së Vitisë si dhe pasqyrat financiare të shpenzimeve publike**
- **Përmes fushatave sensibilizuese, shpërndarjes së fletëpalosjeve është bërë vetëdijësimi i qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre**
- **Është bërë fuqizimi i zbatimit të mekanizmave të krijuara për dorëzimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, ku qytetarët kanë mundësinë që ankesat e tyre ti dërgojnë edhe në Web faqen zyrtare të Komunës**

Viti, Dhjetor 2022






Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Procurar - Priliceno Më/Dana		09-12-2021	
Nr. i organit Org broj	Numri/Broj	Shtëpisë Prilic	Vlera Vrednost
027046/01		1415	



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Vitina

## INFORMATË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË KKSb-së PËR VITIN 2022

Viti, Dhjetor 2022

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.27/2012MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe Planin e Punës së KKSBB-së për vitin 2022, ku kanë qenë të parapara një sërë objektiva dhe aktivitete për realizimin e këtyre objektivave, KKSBB ka kryer këto aktivitete:

- Janë mbajtur 6 takime të KKSBB-së, ku në këto takime përveç raportimit të rregullt të gjendjes së sigurisë në Komunë e Vitisë, nga Policia e Kosovës, janë shtjelluar tema të ndryshme rreth çështjes së sigurisë publike të qytetarëve.
- Në lokalitete të ndryshme të Komunës së Vitisë është rregulluar sinjalistika horizontale dhe vertikale në komunikacion
- Janë rregulluar trotuare në shumë zona të komunës
- Është rregulluar ndriqimi publik në disa zona të Komunës
- Policia e Kosovës, bazuar në Planin e KKSBB-së dhe në planet e saja operacionale ka kryer një sërë aktivitetesh të cilat janë realizuar në komunitet dhe me nxënës në shkollë e të cilat janë:

Organizimi i ligjëratëve në disa shkollë të Komunës së Vitisë me këto tema: Parandalimi i trafikimit me njerëz, Parandalimi i dhunës në familje, lajmet e rreme ( Fake News), parandalimi i përdorimit të narkotikëve, keqpërdorimi i rrjeteve sociale (krimet kibernetike), ku këto aktivitete janë realizuar edhe nga QPS, psikologë shkollorë dhe gazetarë lokalë

- Janë formuar ekipet e nxënësve për siguri në shkollë, të cilat do të identifikojnë problemet e nxënësve që cenojnë sigurinë e nxënësve në shkollë dhe do të propozojnë masa për parandalimin dhe luftimin e tyre
- Është funksionalizuar Këshilli Komunal për Parandalimin e Dukurive Negative nga të rinjtë, i cili këshill është duke hartuar propozim masa të reja në parandalimin e këtyre dukurive
- Komuna në bashkëpunim me forumet e sigurisë siç janë Policia dhe EVSB ka shënuar javën për të drejtat e viktimave të krimit, ku janë shpërndarë posterë me moton “ Thyeje heshtjen, raporto viktimat e krimit”
- Komuna e Vitisë, ka shpallur vitin 2022 vit të mbrojtjes së pyjeve, ku në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe sektorin e pyjeve janë vendosur pikat statike për kontrollimin e pyjeve në mënyrë të pengimit të dëmtimit të pyjeve nga persona të papërgjegjshëm si dhe ka shpërndarë posterë me mesazhe për mbrojtjen e pyjeve
- Policia e Kosovës vazhdimisht ka bërë patrullimin e rrugëve frekuentive me nxënës të shkollave si dhe gjatë orarit të vajtjes së tyre në shkollë dhe anasjelltas

- Mbajtja e takimeve të rregullta ndër institucionale dhe ndër komunale : KKSB-EVSK-KLSB, të tjerë
- Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarve policer për konceptin e policimit në bashkësi
- Policia e Kosovës përmes planeve operative dhe të vazhdueshme ka ushtruar kontrollë të trafikut rrugor për të zvogluar aksidentet
- Zyra për Riatdhesim ka ofruar vazhdimisht shërbime dhe udhëzime për personat e riatdhesuar
- Policia e Kosovës në vazhdimësi ka zbatuar Planin operativ për siguri në shkolla, ku rregullisht ka monitoruar sigurinë në shkolla
- Policia e Kosovës ka bërë rregullisht patrullimin e rrugëve gjatë fushatës së korrje shirjeve përgjatë muajit Korrik
- Policia e Kosovës ka bërë patrullimin e rregullt në trafik gjatë qëndrimit të mërgimëtarve në vendlindjet e tyre ( përgjatë muajit Korrik – Gusht)
- Me datë 20 Tetor është bërë hapja e fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore me moton “ Mos Hesht”, ku është mbajtur tryezë me përfaqësues nga niveli lokal dhe qendror, ku secili nga përfaqësuesit ka prezantuar angazhimet dhe obligimet që kanë në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie si dhe për në muaj janë mbajtur aktivitete të shumta me nxënës në shkollat e mesme të larta si dhe në ato të mesme të ulëta
- Me datë 25 Nëntor është bërë hapja e fushatës për parandalimin e dhunës në familje me moton “ Asnjë më shume” e cila është shënuar 16 ditë me aktivitete të shumta në shkolla dhe komunitet dhe janë shpërndarë posterë me mesazhe sensibilizuese për parandalim dhe raportim të rasteve viktime të dhunës

Dhjetor, Viti

